



Ne baze te nenit 12, paragrafi 1 dhe 2, shkronja (d) nenit 17, paragrafi 1, shkronja (c) të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008", nenit 10, pika 1.5, te Ligjit Nr-04/L-144, për dhënien ne shfrytëzim dhe këmbimin e pronës se paluajtshme te Komunës, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-35/2012", nenit 20, pika 7 dhe 11, të Rregullores QRK, Nr-23/2013, për përcaktimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim dhe këmbimit të pronës së paluajtshme të Komunës, Kuvendi i Komunës në Suharekë në mbledhjen e mbajtur me datën, -----, miratoi këtë:

**Projekt-V E N D I M  
PËR CAKTIMIN E LOKACIONIT PËR VENDOSJEN E TRAFOSTACIONEVE  
DHE DHËNIEN NË SHFRYTËZIM AFATGJATË TË PRONËS SË  
PALUAJTSHME TË KOMUNËS**

**Neni 1**

Me këtë vendim caktohet lokacioni për vendosjen e trafostacionit TSSH nga KEDS-si dhe dhënia në shfrytëzim afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës, si më poshtë:

Në qytetin e Suharekës në parcelën kadastrale **P-72116046-00711-0**, me sipërfaqe të përgjithshme prej; **2347m<sup>2</sup>**, sipas certifikatës së pronës **nr. 4007/2018**, datës 04.10.2018, zona kadastrale **Suharekë**, vendi i quajtura "**Fshat**", e **evidentuar pasuri shoqërore rrugë e cila menaxhohet nga Kuvendi Komunal-Suharekë**, nga sipërfaqja e përgjithshme e cekur më lart ndahen **15m<sup>2</sup>** për vendosjen e trafostacionit.

**Neni 2**

Pronat e cekura në neni 1, të këtij vendimi jepen në shfrytëzim pa kompensim në afat për 99 (nëntë dhjetë e nëntë) vite.

**Neni 3**

**3.1 OBLIGOHET** shfrytëzuesi i cekur në **nenin 1**, të këtij vendimi, që pronën e paluajtshme, ta shfrytëzon me mirëbesim si nikoqir i mirë, që mos t'ia humbë vlerën e saj.

**3.2** Prona e paluajtshme në fjalë nuk e ndërron titullarin juridik, pronarë i saj mbetet Kuvendi Komunal i Suharekës dhe si e tillë ajo nuk mund t'i epet personit të tretë në shfrytëzim nga ana e shfrytëzuesit, nuk mund të tjetërsohet, nuk mund të jetë objekt i ndonjë barre tatimore apo çfarëdo ngarkese tjetër mbi këtë pronë.

**3.3** Komuna e Suharekës e ruan të drejtën kur do herë që sipas nevojës për realizimin e interesave publik të Komunës të ndryshoj lokacionin në një vend tjetër.

#### **Neni 4**

Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shërbime Pronësore-Juridike dhe Kadastër dhe Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim dhe Mjedis e Komunës së Suharekës, të cilat do të bëjnë parcelizimin dhe skicimin në teren për vendosjen e trafostacionit dhe regjistrimin e gjendjes në librat kadastrale.

#### **Neni 5**

Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës në Suharekë, ky vendim hyn në fuqi 15, ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, në kuptim të nenit 81, të Ligjit Nr-03/L-040, për vetëqeverisjen lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008" dhe nenit 8, të Rregullores (QRK), Nr-01/2016, për shqyrtimin administrativ të akteve të Komunave dhe pas shpalljes publike në tabelën e shpalljeve ose web-faqen e Komunës.

### **KUVENDI I KOMUNËS-SUHAREKË**

01-Nr-\_\_\_\_\_  
Më datë\_\_\_\_\_

**Kryesuesi i Kuvendit**  
\_\_\_\_\_  
**Bexhet KUÇI**